



Republika e Kosovës


Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration



Për :	Bekim Jashari, Kryetar i Komunës së Skenderajt Fatbardha Haliti, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Skenderajt
Kopje	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Adrijana Hodžić, Ministre e MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së
Nga:	Xhevat Tafa, u. d i Drejtorit të Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL Datë: 09/07/2019 Nr. 020-791
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim të ligjshmërisë së aktit të komunës së Skenderajt
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës

I nderuar Kryetar,
E nderuar Kryesuese,

Në pajtim me Rregulloren e QRK-së Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim nr. 01-020/04-0040971/19 për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës
I miratuar më datë më datë: 28.06.2019
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 05.07.2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.
1.	Vendim nr. 01-020/04-0040971/19 për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës se paluajtshme të komunës së Skenderajt	Vendim nr. 01-020/04-0040971/19 i Kuvendit të Komunës së Skenderajt është në kundërshtim me Ligjin nr. 06/I-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 17 paragrafi 2, ku thuhet se “Kuvendi i Komunës propozon dy (2) anëtarë nga Kuvendi i Komunës nga radhët e subjekteve të ndryshme politike”. Arsyeja është se 2 (dy) nga anëtarët e kuvendit të komunës të votuar në përbërjen e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës paluajtshme të komunës janë nga “subjekt i njëjtë politikë”

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kërkon nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za :	Bekim Jashari, gradonačelnik Opštine Srbica Fatbardha Haliti, predsedavajuća Skupštine opštine Srbica	
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Adrijana Hodžić, ministarka MAPL-sa Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-u.	
Od:	Xhevat Tafa, v.d. rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS	Datum, 09.07.2019.
Predmet:	Zahtev za reviziju zakonitosti akta Skupštine opštine Srbica	Br.020/791
Vrsta akta:	Odluka Skupštine opštine	

Uvaženi gradonačelnice,
Uvažena predsedavajuća,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka br. 01-020/04-0040971/19 za formiranje komisije za procenu davanja na kratkoročno i dugoročno korišćenje nepokretne imovine opštine
Usvojena dana, 28.06.2019. godine,
Predložena za razmatranje u MALS-u, dana, 05.07.2019. godine,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje **da je akt u suprotnosti sa zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi** i kao takav ne može proizvesti pravni učinak.

U nastavku ćete naći neusklađenost predloženog akta opštine za razmatranje zakonitosti kao u nastavku:

Br.	Formulisanje u aktu opštine	Zakonska odredba sa kojom jje akt opštine u suprotnosti.
1.	Odluka br. 01-020/04-0040971/19 za formiranje komisije za procenu davanja na kratkoročno i dugoročno korišćenje nepokretne imovine opštine.	Odluka br. 01-020/04-0040971/19 Skupštine opštine Srbica je u suprotnosti sa Zakonom br. 06/1-092 o davanju na korišćenje i razmenu nepokretne imovine opštine, član 17. stavka 2, gde se ističe da "skupština opština predlaže dva (2) člana Skupštine opštine iz redova raličitih politilkih subjekata". Razlog toga je: da dva (2) člana iz Skupštine opštine koji su glasani u sasatavu komisije za procenu za davanje na korišćenje i razmenu nepokretne imovine opštine su iz istog "političkog subjekta"

Na osnovu gore navedenog, Ministarstvo administracije lokalne samouprave, od Skupštine opštine i gradonačelnika traži da preduzimaju konkretne mere kako bi akt opštine uskladili sa zakonskim odredbama na snazi, unutar predviđenog vremenskog roka od 30 dana od dana prijema zahteva za razmatranje akta.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštini za dalja objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

V E N D I M

- I. Miratohet propozimi-vendimi nr. 02-020/04-0034239/19 i dt.12.06.2019, për formimin e Komisionit vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë dhe afatshkurtër.
- II. Komisioni i emëruar si në nenin I ka përbërje prej (5) pesë anëtarëve:
1. Raniz Shala, anëtar i ekzekutivit,
 2. Sanije Ahmeti, anëtare e ekzekutivit,
 3. Sami Aruçi, anëtar, i KK-së. PDK
 4. Albert Rexhepi, anëtar, i KK-së. PDK
 5. Milazim Mustafa anëtar, IQ Skenderaj.
- III. Vendimi për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të komisionit aprovohet në Kuvendin e Komunës me shumicën e votave të anëtarëve prezent dhe që votojnë.
- IV. Detyrat dhe përgjegjësitë Komisionit vlerësues është: caktimi i Kryesuesit të Komisionit, përpilimi i njoftimeve publike dhe të dhënat për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, prezenca në ankand publik/hapjen publike të ofertave, vlerësimi final i ofertave ekonomikisht me të favorshëm, në pajtim me kriteret e përcaktuara me njoftimin për ankandin publik dhe shprehje të interesit.
- V. Administrata e komunës ofron përkrahje komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
- VI. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës.

VII. Ky vendim hyn në fuqi, 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPI-së, si dhe publikimit të tij në ueb – faqen të Komunës.

Vendimi i Dërgohet :

1. Anëtarëve të Komisionit,
2. MAPI-së,
3. Zyrës së Kryetarit,
4. Arkivit,
5. Dosjes.

